

Teto 2025

Raporti gjashte mujor i punës për vitin 2025

NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH. A.	
GJP "AUTOBUSKA STANICA" A. D.	
MPE "BUS STATION" J. S.	
No.	02/3183
Date	31.10.2025
PRISHTINE/A	



Republika e Kosoves
 N.P.L "Stacioni Autobusëve
 Prishtinë" sh.a



NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A. PRISHTINË
 GJ.P "AUTOBUSKA STANICA" A.D. PRISHTINA
 MPE "BUS STATION" J.S. PRISHTINA

Përmbajtja e dokumentit

1	Informata të përgjithshme	3
2	Përmbledhje ekzekutive	4
3	Prezantimi	4
3.1	Pasqyra e strukturës organizative e ndërmarrjes	4
3.1	Informacion i përgjithshëm lidhur me burimet njerëzore në ndërmarrje	4
4	Drejtoria e Administratës	6
4.1	Zyra Ligjore	6
4.2	Zyra e Burimeve Njerëzore	7
	Muaji Qershor	8
4.3	Zyra e Marketingut dhe Shitjes	10
4.4	Zyra e shërbimeve për Mbrojtje, Siguri dhe Shëndet në punë	11
5	Drejtoria e Operativës	12
5.1	Shërbimi i transportit	12
5.1.2	Numri i përgjithshëm i nisjeve të realizuara për 6 muajt e vitit të vitit 2025	13
5.1.3	Krahاسimi i nisjeve të realizuara në 5 vitet e fundit 2021/2025	14
5.1.4	Krahاسimi i numrit të biletave të udhëtimit të shituara 2024/2025	14
5.2	Raporti i punës për Shërbimin Teknik mirëmbajtja teknike	14
5.3	Raporti i punës për Shërbimin Teknik Mirëmbajtja higjienike-sanitare Gjithashtu janë kryer edhe pune të tjera të rëndësishme si ne vijim:	17
6	Drejtoria e Shërbimeve të Përbashkëta	22
6.1	Sigurimi	22
6.2	Digitalizimi dhe TI-ja	23
6.3	Zyra për Mbarvajtjen e Proceseve të punës	25
7	Prokurimi	25
8	Marrëdhëniet me publikun	27
9	Zyrtarë për Planifikim, Zhvillim dhe Koordinim	30
9.1	Objektivat e parapara për TM2 2025	31
9.2	Aktivitetet dhe të arriturat gjatë TM2 2025	32
9.3	Bashkëpunimi me Komunën e Prishtinës	32
9.4	Ndjekja e kërkesave institucionale	33
9.5	Analiza e gjendjes së funksionimit të ndërmarrjes & Propozimi i investimeve të vogla dhe përmirësime estetike	33
9.6	Përgatitja për incizim-matjen e hapësirave afariste	33
9.7	Finalizimi i dokumentacionit për vlerësim të hapësirave	34
9.8	Mbështetje për rregulloren e re për hapësirat afariste & Përgatitja për ankandet publike	34
9.9	Objektivat e planifikuarra për TM3 2025	35

MPE "Bus Station" J.S. Prishtina

NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë

1 Informata të përgjithshme

Emri i ndërmarrjes:	NPL "Stacioni i Autobusëve" sh.a. Prishtinë
Shkurtesa:	SAP
Pronar:	Kuvendi Komunal i Prishtinës
Komisioni i aksionarëve:	1. Nora KELMENDI 2. Gëzim SVEÇLA
Bordi i drejtorëve:	1. Pajtim DEMAJ - Kryesues 2. Arta RAFUNA - Anëtar 3. Dielleza NAMANI - Anëtar 4. Luan HOTI - Anëtar 5. Veton R. PRELVUKAJ - U.D. Kryeshef Ekzekutiv
Kapitali i ndërmarrjes:	11,955,624€
Hapësira/ha:	7 ha e 62 ari e 29 m ² ,
Numri i personave:	24
Numri i hapësirave afariste:	33
Te hyrat për dy mujin e vitit 2025	716,076.20 €
Shpenzimet për dy mujin vitin 2025	628,553.49 €
Numri i punëtorëve:	87
Mosha mesatare:	45.58
Balanci gjinor:	53 meshkuj / 34 femra.
Ueb & domain	www.sap-rks.com

NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë

MPE "Bus Station" J.S. Prishtina

Rr. Bill Clinton p.n., 10000 Prishtine, Republika e Kosoves T: + 383 (0) 38 550 123 www.sap-rks.com info@sap-rks.com

2 Përmbledhje ekzekutive

NPL "Stacioni i Autobusëve" sh.a. Prishtinë është ndërmarrje publike komunale e cila me shërbimet e ofrura ka rëndësi të posaçme, që përveç se bënë lidhjen e kryeqytetit të vendit tonë me pika të ndryshme vendore dhe ndërkomëtare, parqet edhe një pasqyrë të rëndësishme jo vetëm të qytetit të Prishtinës por edhe të Republikës së Kosovës në të gjitha aspektet duke filluar me atë kulturor, funksional etj.

Bazuar në skemën organizative gjatë vitit 2025 kanë qenë të punësuar 87 punëtorë, prej tyre 53 meshkuj dhe 34 femra me një moshe mesatare prej 45.58 vitesh. Struktura organizative e ndërmarrjes është e ndare në tri (3), drejtori. Ndermarrja realizon të hyra vetanake dhe nuk varet nga buxheti komunal. Burimet kryesore të të hyrave janë, shërbimi i personizimit (pranimi dhe përcjellja e autobusëve), shërbimi i shitjes së biletave të udhëtimit për operatorët e transportit rrugorë të udhëtarëve, shërbimi i ruajtjes së bagazhit të udhëtarëve, shërbimi i parkingu për automjete, shërbimi i poligoneve për auto shkola, qiradhënia e lokaleve afariste në pronësi të Stacionit të Autobusëve Prishtinë.

3 Prezantimi

Ky raport gjase mujor bazohet në Ligjin mbi ndërmarrjet publike nr. 03-L-087, nenin 31

Prandaj, bazuar në detyrimet dhe përgjegjësit, të cilat rrjedhin nga ligji mbi ndërmarrjet publike. Ky raport prezanton në mënyrë të qartë, të gjitha veprimet e ndërmarrja nga ana e menaxhmentit të ndërmarrjes në drejtim të realizimit të objektivave të parashtruara për vitin 2025.

Ky raport do të prezantojë strukturën organizative të ndërmarrjes, e cila përbën pjesën më të vlefshme të ndërmarrjes, ku dihet që, burimet njerëzore janë aset kryesor i çdo ndërmarrjes, sepse, pa këto burime shumë vështirë do të mund të realizohen të gjitha synimet e planifikuarra respektivisht, objektivat e planifikuarra me qëllim që ndërmarrja të ketë suksesin e synuar.

Çështjet juridike kanë rëndësi të veçantë për ndërmarrjen, si rrjedhojë të njëjtat kanë ndikim të madhe në suksesin e ndërmarrjes prandaj, do të bëhet prezantimi i të gjitha veprimëve të ndërmarrja të operojë në një ambient sa më të mirë të punës duke u bazuar në ligjet dhe rregulloret në fuqi.

3.1. Pasqyra e strukturës organizative e ndërmarrjes

3.1. Informacion i përgjithshëm lidhur me burimet njerëzore në ndërmarrje

NPL "Stacioni i Autobusëve" sh.a. Prishtinë, ka Bordin Drejtues (BD), në kuadër të të cilit vepron edhe Komisioni i Auditimit të zgjedhur nga komuna e Prishtinës, e cila është aksionar i ndërmarrjes, Kryeshefi Ekzekutiv (KE), Sekretarin, Zyrtarin e Kryesore Financiar dhe të Thesarit (ZKFTH) të zgjedhur nga BD-ja si dhe Zyrtarin e Auditimit të Brendshëm (ZAB) të zgjedhur nga komisioni i auditimit. Bazuar në skemën organizative gjatë vitit 2025 kanë qenë të punësuar 87 punëtorë, prej tyre, 53 burra dhe 34 gra me një moshe mesatare prej 45.58 vitesh. Bazuar në Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendëve të Punës, të datës 31.01.2025, me numër protokoll 02/147, struktura organizative e

NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë

MPE "Bus Station" J.S. Prishtina

4

Drejtoria e Administratës

4.1. Zyra Ligjore

Raporti i punës përfshinë aktivitetet e Zyrtarit Ligjor gjatë periudhës gjashtëmujore te vitit 2025.

Detrat dhe përgjegjësit e punës së Zyrtarit Ligjor janë të parapara me rregulloren për sistematizimin dhe përkrahimin e detyrave të punës.

Të gjitha aktivitetet e Zyrtarit Ligjor, si për periudhën e raportimit dhe periudhëve tjera bazohen në rregulloren e sipër cituar dhe akteve tjera Ligjore e nen ligjore.

Në mungesë të Sekretarit, gjatë janarit dhe me kërkesë të UD Kryeshefi Ekzekutiv dhe BD Zyra Ligjore ka gene e përfshirë në ndërmarrjen e veprimëve juridike administrative në përgatitjen e konkursit për Sekretar të ndërmarrjes.

Gjatë periudhës së raportimit, ZL ka përfqësuar ndërmarrjen në seancat gjyqësore lidhur me kontestet civile:

KE.nr.222/23 Rasti me Enter shpk (kërkesë për kompensim të demit)

C.nr.6796/21 Rasti Sahit Vitia (kontest Pune)

Ndërmarrja gjatë periudhës së raportimit, nga Inspektorati i Punës është pranuar vendimi me NR.01-25-83/2024 për shqiptim të gjobes. Nga zyra Ligjore është përgatitur ankesa kunder vendimit.

Me kërkesë të UD KE-se dhe BD, nga zyra ligjore janë draftuar një sërë vendimesh që ndërliqhen me aktivitetet dhe mbarevatjen e procesit të punës në ndërmarrje.

- Pranimi shpërndarja dhe ruajtja e shkrësavë zyrtare,

Në zyrën e protokolit dhe të arkivit të ndërmarrjes, sipas librit kryesor të protokolit janë të pranura dhe protokoluara gjithësesj 584 dokumente zyrtare.

- Angazhime tjera

Brenda TM 1 në zyrën e Ligjore janë kontrolluar draft kontratat mbi ofrimin e sherbimeve në mes SAP dhe Operatoreve të transportit të udhëtarëve .

Sherbimi i Administratës gjatë kesaj periudhës, ka vazhduar përmbyshjen e detyrave dhe përgjegjësi të sherbimit.

Në kuadër të fushëveprimit të sherbimit të Administratës hyjnë gëshjet ligjore administrative, Burimet Njerzore, Arkiv, Protokol, Marketingut dhe shitje si dhe Sherbimi për mbrojtje, siguri dhe shëndet në punë, me detyra dhe përgjegjësi të specifikuara në aktet e brendshme të Ndërmarrjes.

Aktivite dhe rezultatet

1. C.nr.5407/2023 - seancat gjyqësore të zhvilluara me datë 03.04.2025 dhe 23.04.2025.

2. Cnr.2020/2022 - seancat gjyqësore të zhvilluara me datë 12.05.2025 dhe 25.06.2025

Ende nuk është mbajtur seanca e shqyrtimit kryesor gjykata ka aprovuar propozimin e paditësit Veton Demiri për nxerjen e ekspertizes financiare nga eksperti financiar,

lenda ende është në proces.

3. Ke.nr.222/23 - seancat gjyqësore të zhvilluara dt. 20.05.2025 (në këtë kontest krahas zyrtarit ligjor ndërmarrja është përfqësuar edhe nga vetë UD Kryeshefi Ekzekutiv).

Lenda ende është në proces.

Nga Kompania e sigurimeve "Siguria" kemi pranuar kompensim prej 185€ dhe është nënshkruar Ujdi jashhtëgjyqësore, ndërsa nga Kompania e sigurimeve Dukagjini kemi

NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë

MPE "Bus Station" J.S. Prishtina

pranuar oferten prej 2585€ ofert kjo e papranueshme dhe të njëjten, Zyra Ligjore e ka ataku në Komisionin e shkallës së dytë – jemi në pritje të përgjigjes.

Zyra Ligjore ka një angazhim të vazhdueshëm edhe në punë tjera dhe detyra tjera të ndërmarrjes, si në hartimin e vendimeve, komisione dhe shkresat të ndryshme etj.

4.2. Zyra e Bursimeve Njëzore

Aktivitetet dhe rezultatet

Procedurat e Rekrutimit

JANAR: Me dt.10.01.2025 në ndërmarrje u evidentua edhe një pruarje e re, u emërua/zgjedh një zyrtarë e lartë në pozitën e punës: "Sekretarë Korporative/Këshilltarë e Përgjithshme". E emëruara themelot marrëdhënie pune me mandate 3 vjeçar.

Me dt:31.01.2025 me vendimin nr.02/147/1 dt: 31.01.2025 të Bordit të Drejtoreve u miratua dhe rregullorja e re: "Rregullore për organizimin e Brendshëm sistematizimin dhe përshtetimin e detyrave të punës në NPL "Stacioni i Autobusëve " sh.a. Prishtinë me nr.02/147 dt.31.01.2025.

MARS: Me dt:04.03.2025, nga Bordi i Drejtoreve u miratua dhe rregullorja: "Rregullore për themelimin e marrëdhënies së punës në ndërmarrjen publike Stacioni i Autobusëve sh.a Prishtinë" nr.02/308 dt:04.03.2025, rregullore me të cilën rregullohen procedurat e themelimit të marrëdhënies së punës si dhe procedurat e rekrutimit.

Përgjatë këtij gjatshmujori, përkatësisht në muajin mars 2025, konkretisht me dt:12.03.2025 konform dispozitave ligjore të Rregulloreve nr.02/147 dt:31.01.2025 dhe "Rregullores me nr. nr.02/308 dt:04.03.2025 për themelimin e marrëdhënies së punës në ndërmarrjen publike Stacioni i Autobusëve sh.a Prishtinë", janë shpallur pozitë e lira të punës dhe rrjedhimisht edhe konkurset për pozitë e punës: "Drejtor i administratës" nr.02/361 dt.12.03.2025, "Drejtor i Operativës" nr.02/362 dt.12.03.2025 si dhe "Drejtor i shërbimeve të përbashkëta" nr.02/363 dt.12.03.2025. Procedura e rekrutimit për pozitë e lartëcurë është zhvilluar bazuar në rregulloren e brendshme: "Rregullore për themelimin e marrëdhënies së punës në ndërmarrjen publike Stacioni i Autobusëve sh.a Prishtinë" nr.02/308 dt:04.03.2025. Konkursët kanë qenë të hapura për aplikim për 15 ditë kalendari, nga dt.12.03.2025 e deri me 26.03.2025 në orën 16:00h. Po ashtu edhe nga Bordi i Drejtoreve i ndërmarrjes është shpallur konkursi për pozitën e punës: "Zyrtar i Auditimit të Brendshëm" me dt:12.03.2025, konkursi mbetet i hapur për 30 ditë.

Sistemit e përkohshme

Në periudhën e fillim vitit është paraqitur nevoja për sisteme të përkohshme për shkak të mungesës së stafit të punëtoreve në pozitën e punës Koordinator i Nderimit për shkak të pensionimit të punëtorit i cili ka ushtruar këtë detyrë, si dhe për pozitën "Asistent i sistemit të dixhitalizimit dh TI-së", pasi që punëtori i cili e ka ushtruar këtë detyrë me vullnetin e tij ka ndërprerë marrëdhënien e punës me institucionin tonë.

Pensionim sipas bazës ligjore : Përgjatë periudhës janar-mars 2025, konkretisht në majin shkurt kemi pasur një rast të shkuarjes në pension të përditës sipas ligjit të punës. Punëtori i pensionuar ka ushtruar detyrën e Dispeçerit të peronave.

Pensionimet e parakohshme: Raste të pensionimeve të parakohshme nuk kemi pasur. Përfashtimisht një punëtore e cila ndodhen në pensionim të parakohshëm nga vitet e kaluara, në pozitën e punës "Likuidator

NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë

MPE "Bus Station" J.S. Prishtina

Shkëputja e marrëdhënies së punës: Përgjate periudhes kohore Janar-Mars 2025, konkretisht ne muajin shkurt 2025 ka pasur një rast te shkëputjes se marrëdhënies së punës, pasi i njëjti ka dhënë dorëheqje nga pozita e tij e punës. Punëtori ka qenë i sistemuar ne pozitën e punës: Asistent i zyrarit te sistemit te dixhitalizimit dhe IT-së.

Pushimet vjetore Përgjate periudhes kohore Janar-Mars 2025 te gjitha pushimet vjetore janë realizuar sipas kërkesave te punëtorëve dhe aprovimit dhe planifikimit te mbiqklyrësve te tyre ne bashkëpunim me zyrën tone. Punëtorët janë ende duke e realizuar pjesën e mbetur te pushimit vjetore te vitit te kaluar, 2024.

Shtytëzimi i pushimit mjekësor: Nga 87 punëtorë sa numëron ndërmarrja jone aktualisht, pushimin mjekësore gjate kësaj periudhe kanë shtytëzuar gjithsej 39 punëtor.

Mungesa nga puna me pagës bazuar ne ligjin me nr.03/L-212: Përgjate periudhes kohore Janar-Mars 2025, bazuar ne nenin 39, te ligjit te punës me nr.03/L-21 ne ndërmarrje ka pas dy raste per mungesë nga puna me rastin e vdekjes se anëtarit te ngushte te familjes njëri rast per vëllau, ndërsa rasti tjetër per motrën ne muajin janar 2025.

Përllogaritja e stazhit të punës 0.5%. Ne fillim te muajit janar sikurse viteve tjera është marrë vendim qe stazhi i punës te përllogaritet për te gjithë punëtorët e ndërmarrjes sipas te dhënave se ne cilin muaj kanë krijuar marrëdhënien e punës ne ndërmarrje.

Përgjate periudhes kohore Janar-Mars 2025 stazhi i punës u përllogarit për 26 punëtor. Masa disiplinore. Sa i përket shqiptimit te masave disiplinore përgjate kësaj periudhe nuk kemi pas shqiptim te masave disiplinore.

Vlerësimi i performancës: Procesi i vlerësimit te rezultateve ne punë (performances) së punëtorëve për vitin 2024 nga ana e mbikëqyrësve te drejtëpërdrejt është finalizimit.

Komisioni disiplinor: Përgjate periudhes kohore Janar-Mars 2025, komisioni disiplinore nuk ka pas ndonjë rast për te trajtuar. Prill dhe maj 2025:

- Gjate muajve prill dhe maj 2025, Zyra e Burimeve Njerezore ishte e fokusuar drejt procesit te finalizimit te procedurave te rekrutimit per pozitat e punës: Drejtor i Administrates, Drejtor i Operatives dhe Drejtor i Sherbimeve te Përbashketa. Pas procesit te finalizimit te punës së komisioneve te ankesave ne përbërje sipas vendimeve nr.02/470 dt.03.04.2025; nr.02/471 dt.03.04.2025 si dhe komisioni ne përbërje nr.02/472 dt.03.04.2025 (Raporti i punës së komisionit te ankesave nr.02/677 dt.02.05.2025- Drejtor i Administrates, raporti i punës së komisionit te ankesave 02/677/1 dt.02.05.2025- Drejtor i Operatives dhe raporti i punës së komisionit te ankesave nr.02/677/2 dt.02.05.2025- Drejtor i Sherbimeve te Përbashketa), si dhe pas përfundimit te procesit te vlerësimit përfundimtar te Komisionit Përzgjedhës (vendimi me nr.02/527 dt.11.04.2025) sipas Raporteve nr.02/695 dt.05.05.2025, Raporti me nr.02/696 dt.05.05.2025 si dhe Raportit te vlerësimit përfundimtar nr.02/697 dt.05.05.2025, themeluan:

Zyra e burimeve njerezore - SAP marrëdhënie pune ne ndërmarrje Drejtor i Administrates, Drejtor i Operatives dhe Drejtor i Sherbimeve te Përbashketa. Ne muajin prill po ashtu u finalizua edhe procedura e rekrutimit nga ana e Bordit te Drejtorëve per Zytarin e Auditim te Brendshëm, e cila lidhi marrëdhënie pune ne ndërmarrje me koha te caktuar (mandat trejtesgar) me dt.25.04.2025.

Muaji Qershor

2025 Gjate muajit qershor 2025, fillimisht nga dt.11.06.2025, Zyra e Burimeve Njerezore ishte e angazhuar me procedurat e rekrutimit te shpallura per pozitat e punës: Udhëheqës i

NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë

MPE "Bus Station" J.S. Prishtina

shërbimit teknik dhe mirëmbajtjes x1 pozite pune, Mirëmbajtjes i higjienës dhe hapësirave gjelbëruese x4 pozita pune dhe Asistent i zyrës ligjore x 1 pozite . Pas përfundimit të afatit të konkursit të jashtëm publik me dt.25.06.2025 në orën 16:00h për pozitat e lartçekura, Njësia e Burimeve Njerëzore brenda afatit të parapara ligjor përfundoj fazën e verifikimit paraparak sipas dispozitave ligjore që burojnë nga rregullorja e brendshme "Rregullore për themelimin e marrëdhënies së punës në ndërmarrjen publike Stationi i Autobusëve" sh.a Prishtinë meqast hartoi edhe Raportet e punës së vlerësimit paraparak për secilen pozite veç e veç. Raportet e vlerësimit paraparak ju bashkëngjiten edhe vendimet e refuzimit të aplikacioneve për të gjitha rastet e ku kandidatet nuk i plotësojnë kushtet e parapara me konkurs. Poashtu me dt.20.06.2025 u hapën konkurset - procedurat e reja të rekrutimit për pozitat si në vijim: Teknik i Teknologjisë Informative x 1 pozite pune, Punëtor i sigurimit x 1 pozite pune, dhe Arkëtar x 3 pozita pune. Procedura e aplikimit për pozitat e lartshënuara do vazhdoj deri me dt.04.07.2025 në orën 16:00h ashtu siç është cekur në shpallje të konkurseve. Sfiduese. Përgjatë kësaj periudhe kohore konsiderohet se ka qenë mjaft sfiduese menaxhimi i procedurave të rekrutimi konkretisht procedura e verifikimit paraparak marr parasysht numrin e madh të kandidatëve të cilët kanë aplikuar për pozitat e lira të shpallura në konkurs dhe afatit të shkurtër kohorë të parapara me Rregulloren për themelimin e marrëdhënies së punës në ndërmarrjen publike Stationi i Autobusëve sh.a Prishtinë me nr.02/308 dt.04.03.2025.

Zyra e burimeve njerëzore - SAP

Në Zyrën e Burimeve Njerëzore është evidentuar edhe dorëheqja (nr.02/687 dt.05.05.2025) nga ZKFTH i Ndërmarrjes dhe të njëjtit i është miratuar dorëheqja me vendim nr.02/687 dt.05.05.2025 dhe rrjedhimisht i është shërbuar marrëdhënia e punës. Me qëllim plotësimit të pozitës së lartë dhe mbarëvajtjes së procesit të punës, Kryesuesi i BD, morri vendim për emërim të perkohshëm në pozitën e punës Uld.ZKFTH me vendim nr.02/953 dt.29.04.2025.

Po ashtu në ZBNJ u evidentuan edhe dorëheqja nga pozita e Antarit të Bordit të Drejtorëve (n.02/678 dt.02.05.2025), si dhe emërimi i antarit tjetër të Bordit të Drejtorëve vendimi me nr.02/681 dt.02.05.2025.

Sistemitet e perkohshme

Edhe në këtë tremujore është paraqitur nevoja për sisteme të perkohshëm për shkak të mungesës së stafit të punëtorëve në pozitën e punës si: Kordinator i Ndërrimit për shkak të pensionimit të punëtorit i cili ka ushtruar këtë detyrë, si dhe për pozitën "Teknik i Teknologjisë Informative", pasiqë punëtorit i cili e ka ushtruar këtë detyrë me vullnetin e tij ka ndërprerë marrëdhënien e punës me institucionin tonë. Pozita "Protokoluse" për shkak të mungesës së punëtorit i cili ishte në shfrytëzim in e të drejtës së tij për pushim vjetor. Poashtu sistemim të perkohshëm kishte edhe në pozitën e punës "Kordinator i shërbimit teknik dhe të mirëmbajtjes" Po ashtu për shkak të procedurave të rekrutimit dhe kërkesa ligjore që burojnë nga Rregullorja nr.02/308 dt.04.03.2025 dhe procedurave të hapura të rekrutimit, përgjatë kësaj periudhe kohore u sistemuan perkohësisht punëtor edhe në pozitat e punës: "Zyrtar Ligjore", "Zyrtar i burimeve njerëzore".

Pensionimet

• Pensionim sipas bazës ligjore:

Përgjatë kësaj periudhe prill-gershor 2025, konkretisht në mujin prill kemi pasur një rast të shkuarjes në pension të përgjithshëm sipas ligjit të punës. Punëtorit i pensionuar ka ushtruar detyrën e "Punëtorit i sigurimit".

NPL "Stationi i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë

MPE "Bus Station" J.S. Prishtinë

• **Pensionimet e parakohshme:** Raste të pensionimeve të parakohshme nuk kemi pasur. Përfashtimisht një punëtorë e cila ndodhen në pensionim të parakohshëm nga vitet e kaluara, në pozitën e punës "Likuikator". Shkëputja e marrëdhënies së punës:

Përgjate kësaj periudhë kohore prill-gershor 2025, konkretisht në muajin maj 2025 ka pasur një rast të shkëputjes së marrëdhënies së punës, pasi i njëjti ka dhënë dorëheqje nga pozita e tij e punës. Punëtori ka qenë i sistemuar në pozitën e punës: ZKFTH.

Pushimet

• **Realizimi i pushimeve vjetore:** Edhe në këtë tremujor prill-gershor 2025, rëndom sikurse muajve paraprak ZBNJ përgjate gjithë kohës arriti të hartoj, evidentoj dhe monitoroj në koordinim me udhëheqësit e tyre paraprak realizimin e pushimit vjetor. Edhe në këtë periudhë kohore për pushim vjetor u shfrytëzuan ditët e bartura nga viti paraprak, në përfashtim të disa rasteve të cilat kanë filluar të shpenzohen edhe ditët të pushimit vjetor nga ky vit aktual 2025. Mirëpo në funksion të mbarëvajtjes së procesit të punës dhe në pamundësi të shfrytëzimit të pjesës së mbetur të pushimit vjetor nga viti 2024, kërkesa për pushim vjetor ju refuzua pesë(5) punëtorëve, me mundësi shfrytëzime të ditëve të mbetura për një periudhë tjetër kohore Poashtu edhe në këtë periudhë kohore cdo mungesë e paarsyetuar në orarin e punës, në vendin e punës, në zbatua në mënyrë të menjëhershme në ditët të pushimit vjetor.

Shfrytëzimi i pushimit mjekësor:

Nga 87 punëtorë sa numrin ndërmarrja jone aktualisht, pushimin mjekësore gjatë kësaj periudhë kanë shfrytëzuar gjithsej 39 punëtor.

Mungesa nga puna me pagesë bazuar në ligjin me nr.03/L-212

Gjate këtij tremujori prill – gershor 2025, bazuar në nenin 39, të ligjit të punës me nr.03/L-212 në ndërmarrje ka pas dy raste për mungesa nga puna me pagesë cdo rast të dhënies vullnetare të gjakut.

Përllogaritja e stazhit të punës 0.5%.

Në fillim të muajit janar sikurse viteve tjera është marr vendim që stazhi i punës të përllogaritet për të gjithë punëtorët e ndërmarrjes sipas të dhënave se në cilin muaj kanë krijuar marrëdhënien e punës në Ndermarrje. Në këtë periudhë tremujore stazhi i punës u përllogarit për 29 punëtor. 4 Zyra e burimeve njerëzore - SAP

Masa disiplinore.

Sa i përket shqiptimit të masave disiplinore përgjate kësaj periudhë kohore konkretisht në muajin gershor kemi pas një shqiptim të masës disiplinore – Suspendim i perkohshëm nga puna për punëtorin il cili ushtron pozitën e punës "Ndihmës i Koordinatorit të shërbimit teknike".

5.2.11. Komisioni disiplinor.

Gjate kësaj periudhë tremujore prill – gershor 2025, komisioni disiplinore nuk ka pas ndonjë rast për të trajtuar.

10. Komisioni i ankesave: Në harmoni dhe në përmbushje të kërkesave ligjore që burojn nga rregulloret e brendshme u krijuar edhe komisioni i ankesave me detyrë për të trajtuar të gjitha ankesat kundër vendimeve të punëdhëniesit nr.02/1112 dt.25.06.2025.

4.3. Zyra e Marketingut dhe Shitjes

Aktivitetet dhe rezultatet

NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë

MPE "Bus Station" J.S. Prishtina

Gjate perudhës, (Janar, Shkurt, Mars 2025) në zyrën për marketing dhe zyrën për klient kanë qenë këto aktivitete:

12.1. Të përgjithshme

Bazuar në të dhënat e arkivuara, në këtë periudhë janë nënshkruar:

- 8 marrëveshje për marketing
- 5 marrëveshje bashkëpunimi me operatorë ndërkombëtar
- 3 ka pas kërkesa të shumta për ndryshim të çmimore
- 135 marrëveshje bashkëpunimi për shfrytëzimin e hapësirave të ndërmarjes, po ashtu
- 1 kërkesa të shumta nga MI-së

Janar, Shkurt, Mars 2025: Janë të nënshkruara dhe gjinden në arkivin e zyrës së marketingut

NR KOMPANIA EMRI MBIEMRI SHUMA

1 SCANDIBUSS AZIZ AZEMI 200 €

2 FERSHPED FLORIJE GASHI 200 €

3 NTP BICI COM MENSUR BICI 200 €

4 NTSH TRAY TOURS SHKELQIM FETAJ 200 €

5 NT FIDANI TOURS LUTFI KRYEZIU 200 €

6 DONI TOURS BLEART VUÇA 200 €

7 UNION TRAVEL SHPK RILIND SARAÇI 200 €

8 SHPK KODRA TOURS FIDAN KODRA 200 €

Gjithsej:

€ 1600.00

Zyra e Marketingut dhe Shitjes, gjate perudhë TM-II, 2025, ka vazhduar me përmbydhjen e detryave dhe përgjegjësi gjate perudhë, stafi i zyrës së Marketingut dhe Shitjes, ka zhvilluar një punë të pa ndërprerë dhe profesionale, me qëllim të arritjes së objektivave të ndërmarjes.

Bazuar në të dhënat e arkivuara, në këtë periudhë janë nënshkruar:

- 8 marrëveshje për marketing
- 3 marrëveshje bashkëpunimi me operatorë ndërkombëtar
- 12 marrëveshje bashkëpunimi me operatorë ndërbane
- 3 ka pas kërkesa të shumta për ndryshim të çmimore
- 14 marrëveshje bashkëpunimi për shfrytëzimin e hapësirave të ndërmarjes

4.4. Zyra e shërbimeve për Mbrojtje, Siguri dhe Shëndet në punë

Aktivite dhe rezultate

Zyra e Shërbimeve për Mbrojtje, Siguri dhe Shëndet në punë, gjate perudhës gjasht mujore, 2025, ka vazhduar me përmbydhjen e detryave dhe përgjegjësi gjate perudhë, stafi i zyrës së mbrojtje, siguri dhe shëndet në punë, ka zhvilluar një punë të pa ndërprerë dhe profesionale, me qëllim të arritjes së objektivave të ndërmarjes

Gjate kësaj periudhe janë përfunduar aktivitete në vijim:

• Deratizimi, dezinfektimi dhe dezinfektimi (DDD) – Është realizuar me sukses faza e parë, dytë dhe e tretë e këtij procesi në muajin qershor, duke përmbydhur kështu planin vjetor për kontrollin dhe parandalimin e përhapjes së demtuesve dhe infeksioneve. Aktivitetet janë zbatuar sipas kalendarit të planifikuar dhe standardëve të përcaktuara.

MPE "Bus Station" J.S. Prishtina

NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë

Vlen të theksohet se, për vazhdimin e shërbimeve për vitin e ardhshëm (periudha 2025/2026), duhet të fillojë procedura e hapjes së tenderit, në mënyrë që të sigurohet vijuesia pa ndërprerje e këtyre shërbimeve jetike. Faza e fundit e deratizimit,dezinfektimit dhe dezinfektimit ka përfunduar me datën 02.06.2025. I gjithë procesi i deratizimit kryhet në tri (3) faza gjdo kater (4) muaj.

- Shqyrtimi i mundësisë për funksionalizimin dhe mirëmbajtjen e hidranteve në ndërmarrje Aktualisht, në hapësirat e ndërmarrjes gjenden gjithsej gjashtë (7) hidrante, të shpërndarë si më poshtë:
 - Kater (4) hidrante të vendosur në hollin kryesor të ndërmarrjes,
 - Një (1) hidrant i vendosur në hyrjen zyrtare të administratës (kati përthes),
 - Një (1) hidrant i vendosur në katin e dytë, të administratës..
 - Një (1) hidrante gjendet në katin e dytë në lokalin e dhen me qera në shfrytëzim është operatori ekonomik caffè HD.
- Gjendja dhe mirëmbajtja e aparateve për fikjen e zjarrit në ndërmarrje
 - Në kuadër të masave për mbrojtjen nga zjarri, në objektin e ndërmarrjes janë të vendosur gjithsej dymbëdhjetë (12) aparate për fikjen e zjarrit, të shpërndarë si më poshtë:
 - Dhjetë (10) aparate të llojit P/6 (aparate portative me pluhur të thatë), të cilat janë të vendosura në:
 - Hollin kryesor të ndërmarrjes,
 - Zyrat e administratës.
 - Dy (2) aparate të llojit P/50 (me kapacitet më të madh), të vendosura në:
 - Hyrjen zyrtare të administratës (1 aparat),
 - Hollin e ndërmarrjes (1 aparat).

Në këtë periudhë, Drejtoria e Administratës është konsideruar si Drejtori e re Organizative në ndërmarrje, ku ka filluar aktivitetet me detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara. Këtë periudhë e karakterizuar implementimi i rregullores së organizimit të brendshëm dhe përmbyllja e raporteve vjetore dhe planifikimeve për vitin aktual.

Aktiviteti i drejtorisë së Administratës për periudhën vijuese kryesisht janë aktivitetet e ngjashme të cilat ndërliqhen me procedurat ligjore, menaxhim të burimeve njerëzore, administrative, menaxhim të kontratave të qirave dhe pronës, dhe detyrat tjera në ndërmarrje. Objektivi i Drejtorisë së Administratës, është përmirësimi gradual dhe i vazhdueshëm në të gjitha fushat e përgjegjësisë. Implementimi i skemës së re organizative me sa më pak rrezique ligjore, mbetet një nga aktivitetet me prioritet të lartë të Drejtorisë.. Objektivi i Drejtorisë, dhe që pritet të përmbyllet në dy mujorin e dytë është zhvillimi i bazës së të dhënave për burimet njerëzore, sigurinë dhe shëndetin në punë dhe qiradhenien. Kjo do të bëjë të mundur një menaxhim efikas të proceseve dhe të dhënave të

5 Drejtoria e Operativës

5.1. Shërbimi i transportit

Shërbimi i transportit ka për qëllim ofrimin e shërbimeve sa më cilësore për Operatorët Transportues që realizojnë nisjet ndërurbane dhe ndërkombëtare nga "Stacioni i Autobusëve" Prishtinë.

NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë
 MPE "Bus Station" J.S. Prishtina

Ne vijim eshte paraqitur raporti i Sherbimit te Transportit dhe numri i niseje per muajin qershor.

Per kete perudhe kohore jane realizuar gjithsej 66,530 niseje, prej te cilave:

1. 53,773 niseje nder-urbane;
 2. 12,245 niseje nderkombetare, dhe
 3. 512 vozitje te lira, turistike
- Ne raport me vitin e kaluar, verehet nje trend ne rritje i niseje nderkombetare

5.1.2. Numri i pergjithshem i niseje te realizuara per 6 muajt e viti te vitit 2025

Ndërmarrja Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve" Sh.A Prishtinë
 Raport i realizimit të niseje ndërbane dhe ndërkombetare për vitin 2025


# Destinacionet	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NETOR	DHJETOR	Total
1 Dobraje	211	192	203	150	139	215							1,110
2 Fenzaj	1349	1252	1374	1396	1334	1239							7,944
3 Gadrine	273	243	241	273	247	247							1,661
4 Gjakove	654	604	655	653	633	619							3,818
5 Gllan	913	831	920	915	930	982							6,491
6 Istog	407	378	412	416	402	383							2,398
7 Janjeve	43	41	44	46	44	40							268
8 Kraishitë	118	109	108	115	113	110							673
9 Lipjan	275	258	277	290	273	267							1,640
10 Magure	84	87	97	74	34	100							476
11 Malishevë	255	237	265	251	246	250							1,604
12 Mitrovicë	371	419	365	706	755	815							3,431
13 Orllan	0	0	0	0	0	16							16
14 Fajë Degan	1035	959	1035	1042	1044	976							6,091
15 Podujevë	0	0	13	206	318	147							684
16 Prizren	994	907	1015	1022	1000	974							6,912
17 Rahovec	451	412	454	455	444	414							2,631
18 Shalë	360	328	355	360	340	339							2,082
19 Shtime	0	0	0	0	0	0							-
20 Shtetëzë/Drenas	926	933	997	964	935	905							6,660
21 Sllovi	72	62	65	40	68	373							403
22 Vozitje e lire	12	37	5	45	45	373							612
Gjithsej linjat	8,803	8,289	8,900	9,446	9,372	9,476							54,286

Ndërkombetare	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NETOR	DHJETOR	Total
23 Austri	133	100	105	129	108	112							687
24 Belgjike	11	8	7	9	7	9							61
25 Beograd	154	139	145	149	147	146							880
26 Budva	8	2	2	2	5	51							26
27 Bujanoc	56	52	55	56	56	51							328
28 Danmark	0	0	0	0	0	0							-
29 Diber	479	215	211	357	225	198							1,686
30 Gjermani	23	20	29	28	30	30							153
31 Herceg Novi	0	0	0	0	0	0							-
32 Gostivare	30	27	30	29	22	29							167
33 Itali	50	31	43	44	44	44							263
34 Kotor	31	28	31	30	29	28							177
35 Luksemburg	1	1	3	1	3	3							12
36 Medvegj	0	0	0	0	0	0							-
37 Novi Pazar	57	47	54	50	50	52							310
38 Novi Sad	0	0	0	0	0	0							-
39 Podgorice	23	20	29	28	23	30							153
40 Presheve	79	62	62	77	70	49							399
41 Shkup	208	191	208	207	204	200							1,218
42 Shqiperi	578	511	566	565	561	545							3,326
43 Slloveni	126	83	88	100	85	72							664
44 Struge	56	57	56	56	48	29							297
45 Suedi	6	2	3	3	5	4							23
46 Tefote	93	106	111	111	106	101							628
47 Turqi	9	23	21	8	17	17							96
48 Ujquin	47	45	49	47	48	54							290
49 Zagreb-Pulla	58	48	53	55	51	52							317
50 Zvicerr	55	41	38	40	43	32							249
Gjithsej linjat	2368	1859	1991	2174	1978	1875							12,245
Gjithsej linjat ndërkombetare	11,171	10,148	10,991	11,619	11,350	11,361							66,530


NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë

MPE "Bus Station" J.S. Prishtina

5.1.3. Krahasimi i nisjeve te realizuara ne 5 vitet e fundit 2021/2025



5.1.4. Krahasimi i numrit te biletave te udhetimit te shituara 2024/2025



5.2. Raporti i punës për Shërbimin Teknik mirëmbajtja teknike

Ne kuadër te shërbimit teknik janë kryer punët e rregullta qe ndërliidhen me mirëmbajtjen dhe higjienën. Gate muajt prill bazuar ne kontratën për furnizim është bere rriinstalmi dhe ndërrimi i komplet ndriçimit ne hollin e pritjes për udhëtar si ne figurën 1 dhe 2



Fillimi i punimeve te ndrigimit ne holl



Pas perfundimit te punimeve Holi i ndricuar

Gjithashtu gjate muajit prill eshte instalimi i kendit te lodrave ne parkun e vogel perballe hyjes ne objekt tek Administrata si ne figuren 1

NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë

MPE "Bus Station" J.S. Prishtina

Rr. Bill Clinton p.n., 10000 Prishtine, Republika e Kosoves T: + 383 (0) 38 550 123 www.sap-rks.com info@sap-rks.com




Figura 1.

Gatë muajit maj është instalimi i i ndërgjimit të personave dhe numrit të secilit person si në figuren 2 dhe 3 të dokumentit




Figura 2

NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë

MPE "Bus Station" J.S. Prishtina

Rr. Bill Kuntin p.n., 10000 Prishtine, Republika e Kosoves T: + 383 (0) 38 550 123 www.sap-rks.com info@sap-rks.com




Figura 3



Figura 4

5.3. Raporti i punës për Shërbimin Teknik Mirëmbajtja higjienike-sanitare Gjithashtu janë kryer edhe pune të tjera të rëndësishme si ne vijim:

Është bërë kositja e barit në 3 parcele si ne vijim:

1. Hapësira prej 60 ari përballë parkingut për autobusë, si ne figurën nr. 4.
2. Hapësira prej 36 ari përballë peronave ndërrurban si ne figurën nr. 5.
3. Hapësira prej 2.67 hektar përball peronave ndërkombehtar e deri te porta numër dy si ne figurën nr. 6.

NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë

MPE "Bus Station" J.S. Prishtina

Rr. Bill Clinton p.n., 10000 Prishtine, Republika e Kosoves T: + 383 (0) 38 550 123 www.sap-rks.com info@sap-rks.com



Figura 5.




Figura 6.

NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë

MPE "Bus Station" J.S. Prishtina

Rr. Bill Kinton p.n., 10000 Prishtine, Republika e Kosoves T: + 383 (0) 38 550 123 www.sap-rks.com info@sap-rks.com




Figura 7.

Eshtë bere zhvendosja e barakave dhe hekurishtes te cilat janë vendosur ne hapësirën te garazhi e autobusëve si ne figurën 8 dhe 9




Figura 8.

NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë

MPE "Bus Station" J.S. Prishtina

Rr. Bill Clinton p.n., 10000 Prishtine, Republika e Kosoves T: + 383 (0) 38 550 123 www.sap-rks.com info@sap-rks.com




Figura 9

Janë vendosur gurë nga betoni si pengesa fizike për të mos u parkuar autobuset në mes të rrugës si në figurën 10.




Figura 10

Kosita dhe mirëmbajtja e hapësirave gjelbëruese ka qenë e rregullt si në figurën 11 dhe 12
NPL "Station i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë
MPE "Bus Station" J.S. Prishtina




Figura 11




Figura 11

NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A, Prishtinë

MPE "Bus Station" J.S. Prishtina

Rr. Bill Clinton p.n., 10000 Prishtine, Republika e Kosoves T: + 383 (0) 38 550 123 www.sap-rks.com info@sap-rks.com

6 Drejtoria e Sherbimeve të Përbashkëta

6.1. Sigurimi

Gjatë periudhës tre mujore punëtorët e sigurimit kanë bërë përpilimin e listave të autobusëve të cilët qëndrojnë në parking gjatë natës, kanë bërë vëzhgimin dhe patrullimet në gjithë territorin e ndërmarrjes si dhe kanë raportuar për secilin ndërrim.

8.1. Të arriturat dhe sukseset

Gjatë kësaj periudhe punëtorët e sigurimit kanë qenë në nivel të detyres si dhe është arritur që të përmbillen pjesërisht pushimet vjetore të pjesa e mbetur e vitit të kuar 2024.

Numri i autobusëve të cilët kanë shfrytëzuar parkingun natën ka qenë:

- Janar 538,
- Shkurt 493,
- Mars 591.

Sfidat dhe pengesat

-Problematik mbetet ndërrimi ne parkingun e autobusëve si dhe ne objektin te garazhet ish taxi Victory ku është bërë kërkesa që të sigurohen dhe rregullohen dyert e objektit si dhe dyert e Administratës të aktivizohen me access control (me ane te kartelave).

Problematik tjetër mbetet bashkëpunimi me koordinatorët e ndërrimit ku nuk njoftojnë për ndonjë incident gjatë ndërrimit. Në zyrën e Sigurimit që përfshin Sigurimin e Administratës , Punëtorët e Sigurimit dhe Mbikëqyresin e Kamerave, gjatë periudhës tre mujore Prill-Qershor puna është zhvilluar në bazë të përgjegjësive dhe punëve te përcaktuara te punëtorëve.

Kërkesa për marrjen e pamjeve në zyrën e Mbikëqyresit të kamerave nga ana e Zyratëve policor gjatë kësaj periudhe kanë qenë tri të cilat janë përcjelle në bazë të Shënimeve Zyrtare dhe procedurave të përcaktuara.

Pas formimit të komisionit te gjendjes aktuale të kamerave në përberje prej tre anëtarëve është pranuar Raporti me vlerësimin e gjendjes aktuale, funksionimin dhe nevojën e instalimeve shtesë të kamerave. Mbetet ne planifikim për muajt e ardhshëm që duke u bazuar ne këtë vlerësim dhe buxhetin e ndarë për kamera te procedohet me planin dhe nevojën e Ndërmarrjes për kamera shtesë .

Raportet e hyrjeve daljeve janë pranuar me rregull çdo dite te cilat janë përcjelle tek zyra e Burimeve Njerëzore dhe Drejtori i Administratës.

Raporti i qëndrimit të Autobusëve gjatë natës në parking është përcjelle çdo dite në mënyrë të rregullt te koordinatorët .

NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë

MPE "Bus Station" J.S. Prishtina

Rr. Bill Clinton p.n., 10000 Prishtine, Republika e Kosoves T: + 383 (0) 38 550 123 www.sap-rks.com info@sap-rks.com

Gjithashtu është ne proces procedura e pranimit të punëtorit të Sigurimit e cila ka qenë pjesë e shpalljes së konkurseve nga Zyra e Burimeve Njerëzore. Gjendja e përgjithshme e Sigurisë në Ndermarrje përcillet nga Sigurimi i Administratës dhe punëtorët e Sigurimit të cilët raportojnë te Përgjegjësi i Sigurimit dhe dergoheh Raport Javor ne Drejtorin e Shërbimeve të Përbashkëta. Planifikohet për periudhën e ardhshme organizimi i trajnimit për Punëtorët e Sigurimit Fizik e cila është e parapare edhe në Buxhetin e Ndermarrjes.

6.2.Digitalizimi dhe TI-ja

Raporti i TM1 sipas përgjegjësive dhe objektivave

Plan i veprimit është përpiluar mbi nevojat e ndermarrjes dhe nga objektivat i cili është i strukturuar në tabelën e mëposhteme.

Legjenda zëbrthyesë:

1	✓	E përfunduar
2	X	E pa përfunduar
3	N/A	E pa aplikushme

Nr.	Pershkrimi i Punëve		
	Janar	Shkurt	Mars
1	✓	✓	✓
2	✓	✓	✓
3	✓	✓	✓
4	✓	✓	✓
5	✓	✓	✓
6	✓	✓	✓
7	✓	✓	✓
8	✓	✓	✓
9	✓	✓	✓
10	✓	✓	✓
11	✓	✓	✓

Aktivitetet tjera

NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë

MPE "Bus Station" J.S. Prishtina

- Mirëmbajtja e sistemeve të (rrjetës kompjuterike, email-ve, webfaqes, sistemeve të informimit, pagesave), intervenimi në rast nevojë edhe nga distanca.
 - Ri-freskimi i uebfaqes së SAP, publikimi i reklamave të Operatorëve Ekonomik në sektorin e reklamave në web faqen e SAP-it
 - Postimi i dokumenteve/raporteve, lajmeve, konkurse, shpallje në webfaqen e ndërmarrjes (të ndryshme).
- LPR Raporti - JANAR-SHKURT-MARS

JANAR

TOTALI MUJORË	
PERONIZIMET ME PARAPAGIM MUJORË DHE PARKINGU GJATË NATËS	666.50 €
PARAPAGIMET MUJORE PËR AUTOSHKOLLAT, FURNIZUESIT, TRANSPORTUESIT, KLIENTET PRIVAT DHE TË TJERËT	8,416.30 €
TOTALI MUJORË	9,082.80 €

SHKURT

TOTALI MUJORË	
PERONIZIMET ME PARAPAGIM MUJORË DHE PARKINGU GJATË NATËS	602.00 €
PARAPAGIMET MUJORE PËR AUTOSHKOLLAT, FURNIZUESIT, TRANSPORTUESIT, KLIENTET PRIVAT DHE TË TJERËT	6,605.80 €
TOTALI MUJORË	7,207.80 €

MARS

TOTALI MUJORË	
PERONIZIMET ME PARAPAGIM MUJORË DHE PARKINGU GJATË NATËS	666.50 €
PARAPAGIMET MUJORE PËR AUTOSHKOLLAT, FURNIZUESIT, TRANSPORTUESIT, KLIENTET PRIVAT DHE TË TJERËT	6,726.80 €
TOTALI MUJORË	7,393.30 €

Në periudhën 3 mujore Maj-Gershor në Zyrën e TI puna është zhvilluar kryesisht nga tekniku i TI. Përveç punëve të zakonshme ditore që përfshijnë asistimin në probleme teknike të pajisjeve kompjuterike , prioritet ka qenë finalizimi i punëve të Operatorit të digjitalizimit .

NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë

MPE "Bus Station" J.S. Prishtina

Ky Operator me te cilin eshte lidhur Kontrata NPL.ST.AUT.-25-150-2-2-1/C113 ne peridhën paraprake Prill 2025 konsiderohet qe ka përfunduar pjesën teknike dhe te instalimin ne mënyrë te suksesshme dhe vazhdon me realizimin e pjesës tjetër te kontratës për menaxhimin e Sistemit të pjesës digjitale të shitjeve dhe laurave.

Në shpalljen e Konkurseve për plotësimin e vendeve të lira të punës në muajin Qershor pjesë e konkursit është edhe pozita e Teknikut të TI e cila momentalisht mbulohet nga punëtori me Vendim për ushtrimin e detyrës te kesaj pozite.

Me dt.30.06.2025 janë implementuar çmimet e reja në Sistem për te realizuar Çmimoren e re Zytare të Peronizimit e cila ka hy ne fuqi me dt.01.07.2025.

6.3. Zyra për Mbarëvajtjen e Proceseve të punës

Zyra për mbarëvajtjen e proceseve të punës ka monitoruar proceset e përgjithshme në Ndermarrje duke dhënë vërejtje dhe rekomandime me Raporte javore. Janë monitoruar proceset e përgjithshme në Ndermarrje duke dhënë vërejtje dhe rekomandime të nevojshme

Zyrtari për Mbarëvajtjen e Procesit të punës ka Udhëhequr procesin për funksionalizimin dhe mirëmbajtjen e Klimave nëpër Zyrat e Ndermarrjes në bashkëpunim me Drejtorin e Administratës për te ofruar një ambient të

përshatshëm të punës për punëtorët ne sezonin e verës .

Rekomandim nga Zyra për mbarëvajtjen e Proceseve të punës ka qenë vendosja e sistemit për verifikim te hyrje-daljes së punëtorëve edhe në zonën e Biletarëve duke u bazuar ne sigurinë e punëtorëve dhe monitorimin e hyrje daljeve. Gjithashtu rekomandohet verifikimi i hidrantëve te ujit ku janë vërejtur kyçje ilegale nga ana e

Operatorëve Ekonomik që shfrytëzojnë hapësirat e Ndermarrjes e cila mbetet te shqyrtohet në peridhën e ardhshme .

Planifikohet që në muajt e ardhshëm pas vendosjes së prioritetëve te vazhdohet me projekte te cilat janë te parapara ne buxhetin e Ndermarrjes për te përmirësuar infrastrukturën dhe nevojat e Ndermarrje

7 Prokurimi

Në peridhën e (TM-1) tremujorit të parë të vitit 2025, zyra e prokurimit ka zhvilluar gjithsej 9 (Nëntë) procedura dhe aktivitete te prokurimit me vlera te përgjithshme prej :

1. Hostimi i Webit dhe Emailëve (Mirëmbajtjeje tri vjeçare) Ofrtues Zero
2. Hostimi i Webit dhe Emailëve (Mirëmbajtjeje tri vjeçare) Ri-tenderim 1,290.00 €
3. Sherbim tre vjeçar për software për menaxhim të kontabilitetit financiar 4,248.00€, (1,416.00 Euro ,Pagesa vjetore)
4. Shërbime vjetore të fotokopjimit dhe mirëmbajtje 0.05 € për kopje
5. Mirëmbajtjeje tri vjeçare dhe Furnizim me sistem të shitjes dhe Laurave Në Proces

NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë
MPE "Bus Station" J.S. Prishtina

Rr. Bill Klinton p.n., 10000 Pristine, Republika e Kosoves T: + 383 (0) 38 550 123 www.sap-rks.com info@sap-rks.com

6. Shërbime për vlerësimin e kënaqshmërisë së konsumatorit 1,049.00 €
7. Furnizimi dhe instalimi të Dritave Led në Hapësirat e brendshme dhe të jashtme në Objektin e SAP-it 1,160.00€
8. Inqizimi-matja e hapësirave të SAP-it Në Proces Furnizim me Motokultivator me pajisje shtesë: Frezë, Kosë dhe pllug Në proces Aktivitetet e prokurimit përfshinë:
9. Furnizim me Motokultivator me pajisje shtesë: Frezë, Kosë dhe pllug Në proces Aktivitetet e prokurimit përfshinë:

7(Shtat) Procedura e Kuotimit të gëmit me vlerë të vogël;

1 (Një) Procedurë e Hapur me vlerë të mesme

1 (Një) Anulim tenderi (Ska Ofertes)

Në periudhën e tremujorit të parë të vitit 2024, zyra e prokurimit ka zhvilluar gjithsej 3 (tri) procedura dhe aktivitetet të prokurimit me vlera të përgjithshme prej:

Shërbime vjetore të fotokopijimit dhe mirëmbajtje

-Çmimi 0.011 € për

Kopje(Kontrate nji vjeqare).

Shërbime për vlerësimin e kënaqshmërisë së konsumatorit

-Çmimi 449.00 €

Furnizimi dhe Montimi me Fusha magnetike

Aktivitetet e prokurimit përfshinë:

2 (Dy) Procedura e Kuotimit të gëmit me vlerë të vogël;

1 (Një) Procedurë e Kuotimit me vlerë minimale Në periudhën e (TM-II-të) tremujorit të Dytë

të vitit 2025, zyra e prokurimit ka zhvilluar gjithsej 14 (Katërmbëdhjetë) procedura dhe

aktivitetet të prokurimit me vlera të përgjithshme prej:

1. Mirëmbajtjeje tri vjeqare dhe Furnizim me sistem të shtjës dhe Laurave - Çmimi 33,555.77€, (932.10 Euro ,Pagesa mujore)

2. Shërbime për vlerësimin e kënaqshmërisë së konsumatorit - Çmimi 1,049.00 €

3. - Furnizimi dhe instalimi të Dritave Led në Hapësirat e brendshme dhe të jashtme në Objektin e SAP-it - Çmimi 1,160.00€

4. Inqizimi-matja e hapësirave të SAP-it - Çmimi 2,100.00€

5. Furnizim me Motokultivator me pajisje shtesë:Frezë,Kosë dhe pllug për nevojat e SAP-it- Çmimi 2,199.00€

6. Backup Ling i Internetit-Shërbim Vjetor-Çmim 1,014.00€, (84.50 Euro ,Pagesa mujore)

7. Furnizim me Uji për Pije " Për nevojat e SAP-it -Çmim 1,000.00€, (1.25 Euro Cent Bidoni)

8. Furnizim me Uniforma për Punëtorët e Ndermarjes-Çmimi 4,535.00€

9. Përgatitja dhe Çertifikimi i Pasqyrave Financiare "për vitin fiskal 2024-Çmimi 600.00€

10. Furnizimi,Konfigurimi dhe Instalimi me DVR"Për nevojat e SAP-it-Çmimi 595.00€

11. Vlerësimi i Pronave të Palujtëshme&Vlerësimi i Çerases së tregut-Çmimi 1,477.00€

12. Furnizim me Karrika dhe Tavolona Pune-Çmimi 931.00€

13. Riparimi i Dyerëve të Hyrjes në Hollin e SAP-it-Anulim i tenderit

14. Riparimi i Dyerëve të Hyrjes në Hollin e SAP-it-Ri-tenderim-Çmimi 2,440.00€

NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë

MPE "Bus Station" J.S. Prishtina

15. Furnizim me Material Hixhenik
Proces

Në

Aktivitetet e prokurimit përfshinë:

- 9 (Nëntë) Procedura e Kuotimit të gëmit me vlerë të vogël;
- 2 (Dy) Procedura me Vlerë Minimale
- 1 (Nji) Procedurë e Hapur me vlerë të mesme
- 1 (Nji) Anulim tenderi (Ska Ofertues)
- 1 (Nji) Procedurë në Proces

8 Marrëdhëniet me publikun

Këtu janë disa nga mënyrat që përdorim për informim:

1. Publikimi i informacioneve – Shpërndarja e lajmeve dhe informacionit të nevojshëm.
2. Komunikata për shtyp – Ndaje informacionin me publikun për ngjarje të rëndësishme.
3. Informimi për veprimtaritë e SAP – Përdorimi i rrjeteve sociale për të njoftuar për aktivitetet që po zhvillohen.
4. Komunikimi i brendshëm dhe i jashtëm – Shpërndarja e informacionit brenda dhe jashtë organizatës.
5. Publikime në faqe interneti dhe rrjete sociale – Vendosja e informacionit në faqe dhe rrjete sociale për të arritur më shumë njerëz.
6. Përdorimi i teknologjive për informim – Përdorimi i mjeteve moderne për të komunikuar shpejt dhe saktë.
7. Në rrjetet sociale, kemi publikuar lajme, njoftime dhe foto që do të tregojnë si është gjendja aktuale në SAP.

Rifreskimi i vazhdueshëm i WEB-faqes

Rifreskimi i vazhdueshëm i faqeve të internetit është një proces i rëndësishëm për të siguruar që informacionet të jenë gjithmonë të azhurnuara dhe të sakta. Detyra kryesore është përpunimi i të dhënave dhe transformimi i informacionit nga inputet në outpute, duke siguruar që vizitorët të kenë qasje në informacion të freskët dhe relevant.

Publikimi i vazhdueshëm i njoftimeve përmes kanaleve të ndryshme Publikimi i vazhdueshëm i njoftimeve është një mënyrë efektive për të siguruar që informacioni të arrijë tek punonjësit, klientët dhe udhëtarët. Ne e dimë rëndësinë e këtij informimi dhe kemi përdorur disa kanale për këtë qëllim:

I. Rrjetet sociale – Aktivitetet i vazhdueshëm në platforma si Facebook, Instagram, Messenger për të shpërndarë lajme dhe njoftime.

II. Uebfaqja e Stacionit – Publikimi i informacionit në faqen e internetit për të mbajtur të informuar vizitorët.

III. Tabela informative – Përdorimi i tabelave për informim të brendshëm të punonjësve.

NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë

MPE "Bus Station" J.S. Prishtina

IV. Për konkurset e jashtme, kemi publikuar mundësi punësimi në platforma si:Kosovajob, Lyp Pune, Puna lme, dhe Oferta Pune.
 Përmirësimi i vazhdueshme i komunikimit me klientë Një mënyrë efektive për t'u treguar klientëve dhe bashkëpunetorëve që jemi të angazhuar për informimin e tyre është krijimi i kanaleve të dyanshme të komunikimit. Kjo i mundëson dy palëve të zhvillojnë një dialog të hapur dhe të vazhdueshëm. Disa nga mënyrat që përdorim për këtë janë:

1. Platforma online – Ku klientët mund të bëjnë pyetje dhe ne u përgjigjemi në kohë reale përmes Facebook, Messenger.
2. Mediat sociale – Ofrimi i mundësive për një komunikim të hapur dhe të rregullt përmes rrjeteve sociale si Facebook dhe Instagram.
- Qëllimi ynë është të plotësojmë vazhdimisht kërkesat e klientëve me informacion të saktë dhe të përditësuar. Po ashtu, kemi zhvilluar intervista në kanale televizive për të ofruar informacion dhe për të komunikuar me audiencën e gjërë.
- Monitoron të gjitha proceset e punës
- Për të genë të hapur dhe për të ofruar informacion të saktë dhe në kohë, Z.I monitoron të gjitha proceset e punës. Kjo na mundëson të:

1. Sigurimi të transparencë – Duke mbajtur klientët dhe bashkëpunetorët të informuar për çdo aktivitet të zhvilluar.
 2. Informim të saktë dhe në kohë – Ne përditësojmë dhe njoftojmë për progresin dhe zhvillimet në proceset e punës.
 3. Përgjigjemi për çdo aktivitet – Sigurohemi që të gjithë palët e interesuara të kenë informacion të plotë dhe të besueshëm rreth aktiviteteve që po zhvillohen në SAP Ky proces ndihmon në ruajtjen e besimit dhe krijimin e një lidhjeje të fortë me klientët dhe partnerët tanë.
- Teknologjia informative dhe informatat janë bërë një ndër burimet më me rëndësi për ekzekutivin gjatë formimit dhe udhëheqjes së një organizate, prandaj edhe ne kemi shfrytëzuar të gjitha rrjetet e mundshme për informim. Raporti i kenaqshmërisë së konsumatorëve,14.04.2023

1. Hartimin dhe publikimin e informacioneve
 2. Komunikata për shtyp
 3. Informimin, lajmërimin për veprimtarinë e SAP
 4. Komunikim të brendshëm dhe të jashtëm
 5. Publikime në WEB faqe
 6. Publikime në Rrjetet sociale
 7. Përdorimin e mjeteve teknologjike për informim dhe lajmërim
- Ne rrjetet sociale do të publikohen informata, njoftime si dhe fotografi që do ta pasqyrojnë gjendjen aktuale në SAP.Informimi i rregullt përmes rrjeteve sociale Këtu janë disa nga mënyrat që përdorim për informim:
 Publikimi i informacioneve – Shpërndarja e lajmeve dhe informacionit të nevojshëm. Komunikata për shtyp – ku ndajmë informacionin me publikun për ngjarje të rëndësishme.

NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë
 MPE "Bus Station" J.S. Prishtina
 Rr. Bill Klinton p.n., 10000 Prishtine, Republika e Kosoves T: + 383 (0) 38 550 123 www.sap-rks.com info@sap-rks.com

Informimi për veprimtaritë e SAP – Përdorimi i rrjeteve sociale për të njoftuar për aktivitetet që po zhvillohen.

Komunikimi i brendshëm dhe i jashtëm – Shpërndarja e informacionit brenda dhe jashtë organizatës.

Publikime në fage interneti dhe rrjete sociale – Vendosja e informacionit në fage dhe rrjete sociale për të arritur më shumë njerez.

Në rrjetet sociale, kemi publikuar lajme, njoftime dhe foto që do të tregojnë si është gjendja aktuale në SAP.

Publikimi i vazhdueshëm i njoftimeve përmes kanaleve të ndryshme

Publikimi i vazhdueshëm i njoftimeve për të siguruar që informacioni të arrijë tek punonjësit, klientët dhe udhëtarët. Ne e dimë rëndësinë e këtij informimi dhe kemi përdorur disa kanale për këtë qëllim:

Rrjetet sociale – Aktiviteti i vazhdueshëm në platforma si Facebook, Instagram, Messenger për të shpërndarë lajme dhe njoftime.

Uebfaqja e Stationit – Publikimi i informacionit në fagen e internetit për të mbajtur të informuar vizitorët.

Tabela informative – Përdorimi i tabelave për informim të brendshëm të punonjësve.

Konkurset janë shpërndarë në uebfaqen zyrtare të SAP dhe në platformat më të përdorura për punësim, përfshirë: KosovaJob, LypPune, Puna lme dhe Oferta Pune.

Përmirësimi i vazhdueshme i komunikimit me klientë, një mënyrë efektive për t'u treguar klientëve dhe bashkëpunëtorëve që jemi të angazhuar për informimin e tyre. Krijimi i

kanaleve të dyanshme të komunikimit i mundëson dy palëve të zhvillojnë një dialog të hapur dhe të vazhdueshëm. Disa nga mënyrat që përdorim për këtë janë:

Platforma online, mediat sociale – Ku klientët mund të bëjnë pyetje dhe ne u përgjigjemi në kohë reale përmes Facebook, Messenger dhe Instagram

Qëllimi ynë është të plotësojmë vazhdimisht kërkesat e klientëve me informacion të saktë dhe të përditësuar. Po ashtu, kemi zhvilluar intervista në kanale televizive për të ofruar

informacion dhe për të komunikuar me audiencën e gjërë.

Monitorimi i proceseve të punës na mundëson për të qenë të hapur dhe për të ofruar informacion të saktë dhe në kohë, ku:

Siç duket nga shprehja e dukur mbajturi klientët dhe bashkëpunëtorët të informuar për çdo aktivitet të zhvilluar.

Informim të saktë dhe në kohë – Ne përditësojmë dhe njoftojmë për progresin dhe zhvillimet në proceset e punës.

Përgjigjemi për çdo aktivitet – Sigurohemi që të gjithë palët e interesuara të kenë informacion të plotë rreth aktivitetëve që po zhvillohen në SAP

Ky proces kontribuon në ruajtjen e besimit dhe ndërtimin e një marrëdhënieje të qëndrueshme me klientët dhe partnerët tanë.

NPL "Stationi i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë

MPE "Bus Station" J.S. Prishtina

Rr. Bill Klinton p.n., 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës T: + 383 (0) 38 550 123 www.sap-rks.com info@sap-rks.com

ZMP ka bërë publikimin e të gjitha aktiviteteve, punëve dhe informatave në interes të bashkëpunetoreve dhe qytetarëve si në vijim:

9 Zytarë për Planifikim, Zhvillim dhe Koordinim

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2025, Zyra për Planifikim, Zhvillim dhe Koordinim ka zhvilluar një sërë aktivitete të fokusuara në zbatimin e objektivave të përcaktuara, me synim përmirësimin e kapaciteteve funksionale të ndërmarrjes, ngritjen e standardeve të shërbimit për udhëtarët, si dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional. Aktivitetet janë realizuar në linjë me prioritetet e planifikuar dhe kanë përfshirë veprime të mirëkoordinuara në fushat e komunikimit institucional. Me poshtë paraqiten drejtimet kryesore të angazhimit të zyrës gjatë kësaj periudhe:

Thellimi i bashkëpunimit me palë të interesit të përbashkët Ne kuadër të objektivave për ndërtimin dhe konsolidimin e marrëdhënieve me institucione të rëndësishme publike, Zyra ka zhvilluar takime zyrtare me përfaqësues të Komunes së Prishtinës, përkatësisht me përfaqësues të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Drejtorisë së Parqeve, si dhe ka bërë përpjekje që të fillojë bashkëpunimin me palë të tjera institucionale.

Qëllimi i këtyre takimeve ka qenë shqyrtimi i mundësive për bashkëpunim teknik dhe financiar, në funksion të rritjes së cilësive së shërbimeve për udhëtarët, si dhe për përmirësimin estetik të hapësirave dhe pamjes së objektit të ndërmarrjes. Janë prezantuar nevojat konkrete të Stationit të Autobusëve në lidhje me ambientin fizik, infrastrukturën mbështetëse dhe gjendjen aktuale funksionale, ndërsa është shprehur gatishmëri e ndërsjelle për bashkëpunim të mëtejme, në përpunje me prioritetet dhe mundësitë buxhetore të palëve.

Hartimi i projekt-propozimeve në fushën e ambientit Ne funksion të përmirësimit të kushteve mjedisore dhe krijimit të një ambienti më të sigurt dhe të shëndetshëm për udhëtarët, Zyra ka hartuar dhe dorëzuar një projekt-propozim të dedikuar për uljen e ndotjes së ajrit brenda hapësirave të ndërmarrjes. Ky dokument synon të adresojë drejtpërdrejt sfidat që lidhen me cilësinë e ajrit në zonat ku qëndrojnë udhëtarët dhe stafi, dhe ofron zgjidhje të bazuara mbi uljen e nivelit të ndotjes së ajrit në hapësirat e stationit. Ky dokument është dorëzuar me datë 14.02.2025 në Drejtorinë e Parqeve në Komunën e Prishtinës.

Inicimi i kërkesave për mbështetje financiare Me qëllim sigurimin e fondeve për realizimin e projekteve infrastrukturore dhe mjedisore, Zyra ka përgatitur dhe adresuar kërkesa zyrtare për mbështetje financiare ndaj institucioneve komunale. Kërkesat janë ndërtuar mbi analizë të nevojave reale dhe prioriteteve strategjike të ndërmarrjes, duke synuar realizimin e ndërhyrjeve me ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e shërbimeve. Kërkesat të cilat janë dorëzuar janë:

- Kërkesë për mbështetje në furnizimin me Pemë në NPL "Stationi i Autobusëve" SH.A.Prishtinë – Drejtorisë së Parqeve në Komunën e Prishtinës. -

NPL "Stationi i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë

MPE "Bus Station" J.S. Prishtina

- Kërkesë për furnizimin, ndërtimin, zgjerimin dhe modernizimin e rrjetit të ndërgjimit të jashtëm në Stationin e Autobusëve – Drejtorisë së Shërbimeve Publike në Komunën e Prishtinës.
- Kërkesë për furnizimin me një kënd lojrash për fëmijë në hapësirat e jashtme të Stationit të Autobusëve – Drejtorisë së Shërbimeve Publike & Drejtorisë së Parqeve në Komunën e Prishtinës, si dhe
- Kërkesë për largimin e genve endacake – Komunës së Prishtinës, respektivisht Ekipit të Menaxhimit të Genve Endacake

Analiza teknike e hapësirave afariste

Në përmbushje të objektivave për menaxhim efikas të hapësirave afariste, Zyra ka hartuar raport të detajuar mbi gjendjen aktuale të hapësirave afariste të cilat janë në pronësi të ndërmarrjes. Raportet përfshijnë të dhëna mbi shfrytëzuesit e hapësirave afariste, numrin e hapësirave afariste, sipërfaqet, vëprimtarinë e tyre, statusin juridik, çmimin, ndarjen e njërive dhe kategorizimin e tyre, duke krijuar një analizë të detajuar mbi funksionalitetin e këtyre hapësirave.

Propozime për përmirësimin e infrastrukturës ligjore në lidhje me hapësirat afariste Në kuadër të rishikimit të dokumentacionit ekzistues, Zyra ka përgatitur ser propozimesh për ndryshimin e Rregullores për dhënie e hapësirave (lokaleve) afariste në shfrytëzim të përkohshëm (qiradhënie) dhe tokës, sipërfaqes për vendosjen e objekteve të përkohshme dhe panove reklamuese me nr.prot.02/130 date 16.07.2019, në mënyrë që të harmonizohet kuadri ligjor me praktikën aktuale dhe të përmirësohet transparencja dhe llogaridhënia në procedurat e qiradhënies. Propozimet adresojnë nevojat për kategorizim të ri të hapësirave, rregulla të garta për vlerësimin e qirave dhe procedura të standardizuar për ankand publik. Përgatitja teknike për incizim matjen e hapësirave afariste

Në funksion të përmirësimit të bazës së të dhënave dhe për të evidentuar m² të saktë dhe të drejtë të hapësirave afariste, Zyra ka hartuar specifikacione teknike të detajuara për shpalljen e procedurës së prokurimit publik për incizim dhe matje të hapësirave afariste. Dokumentacioni teknik është ndërtuar në përputhje me standardet profesionale dhe në bazë të nevojave aktuale të ndërmarrjes. Ky raport është paraparë të përfshijë: Përkrahim të detajuar të hapësirave afariste, shtrirja e hapësirës, metodologjia e matjes, procesi i matjes, sipërfaqja totale e hapësirave afariste, si dhe rekomandimet për përmirësimin e procesit të matjes. Gjate tremujorit të dytë të vitit 2025, Zyra për Planifikim, Zhvillim dhe Koordinim ka zhvilluar një sere aktivitetesh të fokusuara në zbatimin e objektivave të përcaktuara, me synim përmirësimin e kapaciteteve funksionale të ndërmarrjes, ngritjen e standardeve të shërbimit për udhëtarët, si dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional.

9.1. Objektivat e parapara për TM2 2025

Duke u mbështetur në punën e bërë gjate tremujorit të parë dhe në vazhden e nevojave që janë identifikuar brenda ndërmarrjes, gjate kesaj periudhe kemi përcaktuar disa objektivat të garta për tremujorin e dytë të vitit 2025. Keto objektivat janë menduar që të ndihmojnë në vazhdimin e proceseve të nisura me herët, por edhe në ngritjen e cilësisë së shërbimeve që i

NPL "Stationi i Autobusëve" Sh.A. Prishtine

MPE "Bus Station" J.S. Prishtina

ofron ndërmarrja, bashkëpunimin me institucionet dhe administrimin sa më efikas të hapësirave afariste, pra anën administrative të tyre.

Fokusi i kësaj faze ka qenë që përmes një gasaje praktike dhe të koordinuar, të shtyjme përpara projektet që ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e shërbimeve, në organizimin e brendshëm të ndërmarrjes, si dhe në përgatitjen e hapave të mëtejshëm drejt funksionalizimit të plotë të disa proceseve që tashmë janë në zhvillim.

Objektivat për këtë tremujor janë formuluar në mënyrë që të sigurojnë një gasje gjithëpërfshirëse dhe të koordinuar në trajtimin e sfidave operative dhe planifikuese, duke përfshirë:

9.1.1. Zhvillimi i bashkëpunimit me Komunën e Prishtinës - Forcimi i lidhjeve me Komunën për mbështetje konkrete në projekte.

9.1.2. Ndjekja e kërkesave institucionale - Përcjellje e vazhdueshme për të siguruar reagim dhe koordinim.

9.1.3. Analiza e gjendjes së funksionimit të ndërmarrjes - Vlerësim i sfidave praktike dhe propozime për zgjidhje.

9.1.4. Propozimi i investimeve të vogla dhe përmirësime estetike - Ndërrhyrje të lehta për përmirësimin e ambientit dhe infrastrukturës.

9.1.5. Përgatitja për incizim-matjen e hapësirave afariste - Sigurimi i kushteve për realizimin e matjeve me OE-në.

9.1.6. Finalizimi i dokumentacionit për vlerësim të hapësirave - Përgatitje për hapjen e tenderit për vlerësim të pronës dhe qirasë.

9.1.7. Mbështetje për rregulloren e re për hapësirat afariste - Dhenie e komenteve për harmonizim të dispozitave me nevojat praktike.

9.1.8. Përgatitja për anketat publike - Hartimi i dokumentacionit për nisjen e procedurave të qiradhënies.

9.2. Aktivitetet dhe të arriturat gjatë TM2 2025

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2025, Zyra për Planifikim, Zhvillim dhe Koordinim ka zhvilluar një sërë aktivitetsh të fokusuar në zbatimin e objektivave të përcaktuara, me synim përmirësimin e kapaciteteve funksionale të ndërmarrjes, ngritjen e standardeve të shërbimit për udhëtarët, si dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstytucional. Aktivitetet janë realizuar në linjë me prioritetet e planifikuar dhe kanë përfshirë veprimet e mirëkoordinuara në fushat e komunikimit institucional. Me poshtë paraqiten drejtimet kryesore të angazhimit të zyrës gjatë kësaj periudhe:

9.3. Bashkëpunimi me Komunën e Prishtinës

Gjatë kësaj periudhe kemi vazhduar angazhimin në drejtim të forcimit të bashkëpunimit me Komunën e Prishtinës, me qëllim që të shtyjme përpara disa nga gëshjet që janë të rëndësishme për ndërmarrjen tonë. Konkretisht, bashkarisht me Kryeshëfjin Ekzekutiv kemi zhvilluar një takim me përfaqësues të Drejtorisë së Parqeve, ku kemi diskutuar për mundësitë e bashkëpunimit në funksionalizimin e hapësirave të jashtme të stacionit - me fokus tek gjelbërimi dhe krijimi i ambienteve më të përshtatshme për qytetarët dhe udhëtarët.

Ky takim ka ardhur si vazhdim i komunikimeve të mëhershme dhe është zhvilluar në një frymë të hapur bashkëpunimi. Është trajtuar konkretisht mundësia që komuna të ofrojë përkrahje, goftë teknike apo materiale, për projekte që ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e kushteve në hapësirat publike përreth stacionit.

NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë

MPE "Bus Station" J.S. Prishtina

Po ashtu, kemi zhvilluar edhe një takim informues me përfaqësues të RBKO-së, ku është diskutuar potenciali për bashkëpunim në ruajtjen e ambientit dhe përfshirjen e tyre në projekte që ndërliken me hapësirat e gjelbra.

Përveç kësaj, kemi mbajtur kontakte të vazhdueshme edhe me përfaqësues të Drejtorisë së Shërbimeve Publike në Komunën e Prishtinës, për të përcjellë nga afer zhvillimet dhe për të ruajtur vijueshmërinë në komunikim institucional për çështjet që kemi ngritur gjatë kësaj periudhe.

9.4. Ndjekja e kërkesave institucionale

Pas takimit me përfaqësuesit e Drejtorisë së Parqeve, kemi vazhduar komunikimin me ta në mënyrë të rregullt, me qëllim që të përcjellim nga afer statusin e kërkesave tona dhe të sigurohemi që ato të trajtohen me seriozitet. Rezultati konkret i këtij angazhimi ishte miratimi i kërkesës sonë me nr. prot. 02/264, datë 25.02.2025, që kishite të bënte me vendosjen e një këndi lojërash për fëmijë në hapësirën e jashtme të stacionit. Ky projekt është realizuar si donacion nga Drejtoria e Parqeve, me vlerë afërsisht 5,000 euro, dhe tashmë është funksional në një nga pjesët më të frekuentuara të zonës.

Gjithashtu, kërkesat që kemi adresuar si zyrë janë marrë parasysh edhe në marrëveshjen që Kryeshëfi Ekzekutiv i ndërmarrjes ka arritur me Kryetarin e Komunës së Prishtinës, z. Përpam Rama. Në këtë marrëveshje janë përfshirë disa nga çështjet që ne i kemi ngritur në vazhdimësi – si ndriçimi i jashtëm, si dhe funksionalizimi i parqeve që janë pjesë e hapësirave të stacionit.

Kërkesë tjetër e cila konsiderohet si e realizuar nga zyra për PZHK është edhe kërkesa për largimin e qenve endacake, e cila është trajtuar pozitivisht nga autoritetet komunale dhe ka rezultuar me reduktim të ndjeshëm të tyre në hapësirat e stacionit.

9.5. Analiza e gjendjes së funksionimit të ndërmarrjes & Propozimi i investimeve të vogla dhe përmirësime estetike

Gjatë kësaj periudhe, me kërkesë të Kryeshëfit Ekzekutiv, kam bërë disa analiza të gjendjes faktike në terren, me qëllim që të identifikoj problemet reale me të cilat përballët ndërmarrja në baza të rregullta. Këto analiza kanë përfshirë aspekte të ndryshme që prekin funksionalitetin, mirëmbajtjen, pamjen e përgjithshme dhe shfrytëzimin e hapësirave.

Bazuar në ato që kam konstatuar në terren, kam përgatitur gjithsej 7 projekt-propozime konkrete, që synojnë të përmirësojnë gjendjen aktuale, si dhe të ndikojnë pozitivisht në cilësinë e shërbimeve dhe në rritjen e të hyrave të ndërmarrjes. Çdo propozim është bërë duke pasur parasysh gjendjen reale dhe kapacitetet që kemi në dispozicion, dhe për secilin kam përfshirë edhe vlerësimin e kostos për realizim.

Propozimet përfshijnë ndërhyrje të natyrave të ndryshme – disa janë të thjeshta dhe mund të realizohen me shpenzime minimale, ndërsa disa të tjera kanë karakter me shumë kapital dhe kërkojnë investim më të madh.

Në thelb, qëllimi im ka qenë që për çdo problem të konstatuar të ofroj një zgjidhje të zbatueshme, që në fund sjell përmirësim konkret në terren dhe rritje të efikasitetit në punën tone të përditshme.

9.6. Përgatitja për incizim-matjen e hapësirave afariste

Ky proces ka ardhur si propozim nga Zyra për Planifikim, Zhvillim dhe Koordinim, me qëllim që të kemi një pasqyrë të saktë dhe të përditësuar të hapësirave afariste që posedon ndërmarrja, së bashku me sipërfaqen reale të secilës prej tyre. Ideja kryesore ka qenë që të evidentohen qartë të gjitha hapësirat afariste dhe të përgatitet një raport që është i saktë, i plotë dhe i përshtatur me nevojat tona konkrete në terren.

NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë

MPE "Bus Station" J.S. Prishtina

Rr. Bill Klinton p.n., 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës | T: + 383 (0) 38 550 123 | www.sap-rks.com | info@sap-rks.com

Pas përfundimit të procedurës së prokurimit dhe përzgjedhjes së operatorit ekonomik, në sipërmarrje të strukturuar dhe të detajuar për çdo njësi afariste dhe sportel, duke përfshirë në mënyrë të veçantë: numrin identifikues të njësisë, përshkrimin e pozicionit fizik, ndarjen e brendshme (lokal, terasë e brendshme, terasë e jashtme), si dhe sipërfaqen totale për secilin hapësirë. Çdo njësi është e paraqitur në një fage të veçantë, duke e bërë më të qartë dhe më të lehtë për identifikim, referencim dhe verifikim teknik apo administrativ. Po ashtu, raporti përfshin metodologjinë e matjes dhe skicat teknike përkatëse, që e bëjnë dokumentin teknikisht të qendrueshëm dhe të përdorshëm në afatgjatë. Nga kjo procedurë, në sipërmarrje kemi arritur që të japim një gjykim të mbështeturë në profesionalizëm mbi sipërfaqen e shfrytëzuar nga qiramarrësit. Pra, si rezultat i këtij procesi të ri të incizimit është arritur të identifikohet dhe dokumentohet me saktësi një pjesë e konsiderueshme e hapësirës reale në shfrytëzim, duke korigjuar mospërpunimet e mëhershme dhe duke vendosur një bazë të unifikuar të të dhënave për administrimin e mëtejme të pronës afariste të ndërmarrjes.

9.7. Finalizimi i dokumentacionit për vlerësim të hapësirave
 Pas përfundimit të procesit të incizimit matjes së hapësirave afariste, është miratuar edhe propozimi i tjetër i paraqitur nga Zyra për Planifikim, Zhvillim dhe Koordinim, që kishite të bënte me vlerësimin e pronave të paluajtshme dhe përcaktimin e vlerës së qirasë për hapësirat afariste.

Duke u bazuar në nevojat praktike të ndërmarrjes për të pasur një raport të besueshëm dhe profesional në këtë fushë, zyra ka hartuar specifikacionin teknik për këtë proces dhe ka gënjë aktive në të gjitha fazat e përgatitjes së dokumentacionit të nevojshëm për hapjen e procedurës së prokurimit.

Pas përzgjedhjes së operatorit ekonomik fitues, zyra është duke e përcjellë në vazhdimësi punën e tij, duke gënjë në komunikim të drejtëpërdrejtë dhe duke i ofruar dokumentacionin dhe informacionin e kërkuar nga OE, që raporti përfundimtar të jetë sa më i saktë, funksional dhe i përdorshëm për ndërmarrjen – sidomos për qëllime të planifikimit, qiradhënies dhe rritjes së të hyrave.

9.8. Mbështetje për rregulloren e re për hapësirat afariste & Përgatitja për ankandet publike

Në lidhje me rregulloren për qiradhënien e hapësirave afariste, gjatë kesaj periudhe kam dhënë disa propozime me qëllim që dokumenti përfundimtar të jetë sa më funksional dhe i zbatueshëm në praktikë, në përputhje me nevojat reale të ndërmarrjes dhe situatën në terren.

Përfundimi i kesaj rregulloreje është i ndërlikuar me përfundimin e raportit për vlerësimin e pronës dhe të vlerës së qirasë për meter katror, i cili është në proces. Vetëm pas këtij hapi do të mund të përcaktohen në mënyrë të saktë dhe të argumentuar gënjimet për secilin hapësirë afariste.

Pas miratimit të rregullores, do të pasojë shpallja e ankandëve publike për hapësirat që janë të lira. Kjo do të bëhet mbi bazën e sipërfaqeve të evidentuara përmes incizimit dhe të dhënave nga raporti i vlerësimit, në mënyrë që çdo hapësirë të ketë një gënjim të drejtë dhe të arsyeshëm për qiradhënien, dhe që procesi të jetë sa më i rregullt dhe transparent.

NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë

MPE "Bus Station" J.S. Prishtina

9.9. Objektivat e planifikuarra për TM3 2025

Duke u mbështetur në punën e dërtanishme dhe në vazhdimësi të proceseve që janë në zhvillim, për tremujorin e tretë të vitit 2025 janë planifikuar një sërë objektivash që kanë për qëllim thellimin e bashkëpunimeve institucionale, finalizimin e dokumentacioneve të rëndësishme për hapësirat afariste, si dhe përgatitjen për fazat e zbatimit në terren. Për këtë periudhë, fokusi do të jetë në ndjekjen e kërkesave të hapura, përgatitjen e kontratave të reja me qiramarresit, përpilimin e Ankandeve Publike për hapësirat e lira, si dhe në mbështetjen për implementimin e rregullores së re – nëse kjo e fundit miratohet nga organet përkatëse. Po ashtu, kjo fazë do të shfrytëzohet për përgatitjen e propozimeve për buxhetin e vitit 2026, në përputhje me nevojat aktuale dhe prioritetet strategjike të ndërmarrjes.

Objektivat e kësaj periudhe do të përqendrohen në këto drejtime:

10.9.1. Vazhdimi dhe thellimi i bashkëpunimit me Komunën e Prishtinës, përmes takimeve të rregullta me njësitë përkatëse komunale dhe ndjekjes së gështjeve të hapura me interes të përbashkët.

10.9.2. Fillimi i takimeve me palë të tjera relevante, që kanë lidhje me funksionimin dhe objektivat strategjike të ndërmarrjes, me qëllim zgjerimin e bashkëpunimeve ndërinstitucionale.

10.9.3. Ndjekja e kërkesave të mëhershme të adresuara institucioneve publike, për të përcjellë statusin dhe për të shtyrë përpara trajtimin e tyre.

10.9.4. Përpilimi dhe adresimi i kërkesave të reja, bazuar në nevojat aktuale të ndërmarrjes dhe zhvillimit në terren.

10.9.5. Finalizimi i procesit për përpilimin e raportëve të vlerësimit të pronave të paluajtshme dhe të vlerës së qirase së tregut, në bashkëpunim me operatorin ekonomik të kontraktuar.

10.9.6. Administrimi dhe përgatitja teknike e dokumenteve që lidhen me hapësirat afariste, duke përshtatur raportet në rregullore, si dhe arkivuar në mënyrë të koordinuar:

10.9.7. Raportin për incizim-matjen e hapësirave afariste;

10.9.8. Raportin për vlerësimin e vlerës së qirase së tregut.

10.9.9. Mbështetja për implementimin e rregullores së re për qiradhenie (nëse miratohet), përmes koordinimit të brendshëm dhe përgatitjes për zbatim në praktikë.

10.9.10. Përgatitja e kontratave të reja të qiradhenies për hapësirat afariste, në përputhje me rregulloren e re dhe vlerësimet e reja financiare.

10.9.11. Organizimi i ankandeve publike për hapësirat e lira, mbi bazën e dokumentacionit të përditësuar dhe procedurave të standardizuara.

10.9.12. Përgatitja e propozimeve buxhetore për vitin 2026, përmes identifikimit të projekteve prioritare dhe përcaktimit të kostove për secilin prej tyre.

Përfundimi

Tremujori i dytë i këtij viti ka qenë një periudhë me shumë angazhime konkrete dhe punë të vazhdueshme në disa drejtime njëkohësisht. Si zyrë kemi qenë vazhdimisht të përfshirë në procese që ndërlidhen me bashkëpunimin me institucionet, përgatitjen e dokumenteve teknike, analizën e gjendjes në terren dhe zhvillimin e ideve të reja për ndërmarrjen.

NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë

MPE "Bus Station" J.S. Prishtina

Gjatë kësaj kohe kemi arritur edhe disa rezultate të prekshme. Disa nga propozimet që kemi paraqitur janë miratuar dhe kanë filluar të zbatohen, ndërsa disa të tjera janë në fazë përpunimi. Besoj se këto iniciativa do të ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen e të hyrave dhe përmbledhimin e shërbimeve që ndërmarrja ofron për udhëtarët dhe qytetarët. Ky zhvillim është realizuar falë angazhimit të drejtpërdrejtë të Zyrës për PZHK dhe me mbështetjen e vazhdueshme të Kryeshefit Ekzekutiv të ndërmarrjes, z. Prelvukaj.

Qasja jonë do të vazhdojë të jetë praktike, e koordinuar dhe e përkushtuar, me qëllim që çdo hap që ndërmarrim të sjellë vlerë të shtuar për ndërmarrjen dhe për publikun që e përdor këtë hapësirë çdo ditë.

Punoi:
U.D. Kryeshef Ekzekutiv
Veton R. PRELVUKAJ



APROVUAR



APROVUAR



NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A. PRISHTINË
NPL GUP - BUS STATION "J.S." PRISHTINA
MPE - BUS STATION "J.S." PRISHTINA
NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A. PRISHTINË

Kryesuesi i Bordit të Drejtoreve
Pajtim DEMAJ

MPE "Bus Station" J.S. Prishtina

NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë

Rr. Bill Clinton p.n., 10000 Prishtine, Republika e Kosoves T: + 383 (0) 38 550 123 www.sap-rks.com info@sap-rks.com